



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 1584 Prot.  
4

Tiranë, më 6/12/2013

**Lënda:** Rekomandim për kontrolluesin subjektit financiar jo bankar *Fondi Besa sh.a Tiranë*.

**REKOMANDIM**

Nr. 52 datë 06/12 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, subjektit financiar jo bankar *Fondi Besa sh.a Tiranë*.

**KONSTATOVA**

Në datë 21/11/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, subjektit financiar jo bankar *Fondi Besa sh.a Tiranë* me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave "Klient" "Punonjës" sipas ligjit 9887 date 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", udhëzimit nr. 21, datë 24/9/2012 "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e mëdhenj".

Kontrolluesi ushtron aktivitet privat si institucion financiar jo bankar në ofrimin e shërbimeve dhe produkte financiare kryesisht për sipërmarrës, të vetëpunësuar, biznese të vogla i shtrirë në disa degë në vend.

Në këndvështrimin e ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kontrolluesi subjekti financiar jo bankar *Fondi Besa sh.a Tiranë*, merr cilësinë e kontrolluesit, pasi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave " klientë " dhe "punonjës".

Ligji nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", në nenin 3 përkufizon; "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Kontrolluesi ofron produkte dhe shërbime në drejtim të dhënies së mikrokredive për, agrobizneset, auto kredi, biznese të mesme, biznese të vogla, kredi konsumatore, agro kredi etj.



Gjatë kontrollit administrativ të ushtruar në funksion të objektit të urdhrit të kontrollit mbi ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale për subjektet e të dhënave “Klient” “Punonjës”, parë në aspekt me ligjin 9887 date 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, grupi i kontrollit ka inspektuar;

- dosjet me dokumentacion dhe të dhëna personale të krijuara për subjektet e të dhënave personale “klientë”, në rastet e lëvrimit të kredive dhe produkteve të tjera.
- Dosjet e subjekteve të të dhënave “punonjës”
- Sistemin elektronik të përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e informacionit.
- Sistemin e mbledhjes përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet kamerave CCTV.
- Ambientet e kontrolluesit për sigurinë dhe ruajtjen e dosjeve më të dhëna personale, politikat e kontrolluesit mbi ruajtjen e të dhënave personale.
- U inspektua në drejtim të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.

Nisur nga relacioni i përpiluar nga grupi i kontrollit administrativ, procesverbali i kontrollit administrativ rezulton se; kontrolluesi *Fondi Besa sh.a Tiranë* garanton mbrojtje të të dhënave personale, nëpërmjet përpunimit të drejtë, të ligjshëm dhe të sigurt të tyre, në sajë të masave që ai ka marrë:

- Ka hartuar rregullore “Për mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”
- Ka hartuar udhëzim “Për mbledhjen përpunimin e të dhënave personale dhe vendosjen e sistemit CCTV”.
- Kontrolluesi ka hartuar “Udhëzim për asgjësimin dhe ruajtjen e dokumenteve që mbahen nga kontrolluesi në qendër dhe degët rajonale”.
- Kontrolluesi ka hartuar “Manualin e brendshëm në sistemin e informacionit” .

Duke marrë në konsideratë konstatimet e grupit të kontrollit administrativ, në kuadrin e masave që kontrolluesi *Fondi Besa sh.a* ka marrë në aspektin e mbrojtjes së privatësisë, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , vlerësoj se kontrolluesi duhet që, në rubrikën “politikat e privatësisë” të faqes së tij të internetit , të përfshijë dhe “politika privatësie” që referojnë me ligjin nr.9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me qëllim ndërgjegjësim masiv të subjekteve të të dhënave personale që vizitojnë faqen tuaj në internet.

Për sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative;

## **REKOMANDOJ**

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi *Fondi Besa sh.a*, të përfshijë në rubrikën “politikat e privatësisë” të vendosur në faqen në internetit dhe kushtet, kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale bazuar në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
2. Kryerja e kësaj detyre të lënë në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej 1(një) muaj, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijeni të këtij rekomandimi.

3. Me plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

